



Banka e Shqipërisë  
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian\*

# VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


7 DHJETOR 2022

*\* Vrojtimet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e harmonizimit të Komisionit Evropian. Prej muajit qershor 2021, publikimi i analizave dhe të dhënave nga vrojtimet publikohen me frekuencë mujore.*

## VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

**Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)** u rrit me 2 pikë në muajin nëntor. Niveli i tij aktualisht qëndron 2.3 pikë mbi mesataren afatgjatë (Grafik 1). Përmirësimi i këtij treguesi u ndikua kryesisht nga rritja e besimit në sektorët e *ndërtimit* dhe të *shërbimeve*. Gjithashtu, përmirësimi i besimit konsumator dhe atij në sektorin e tregtisë ndikuan pozitivisht rritjen e TNE-së, megjithëse në një masë më të vogël (Grafik 2). Nga ana tjetër, besimi në sektorin e industrisë regjistroi rënie në muajin nëntor.

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

**Treguesi i besimit të industrisë (TBI)** ra me 3.8 pikë përqindjeje krahasuar me muajin e kaluar, i ndikuar si nga vlerësimet më pesimiste për prodhimin aktual ashtu edhe nga vlerësimet në rënie për kontratat porositëse. Ndërkohë, pritjet e *bizneseve* për *prodhimin* në të ardhmen regjistruan një rritje të lehtë. Pritjet për çmimet janë në rënie këtë muaj (Tabelë 2, sektori i industrisë).

**Treguesi i besimit në ndërtim (TBN)** regjistroi rritje me 5.8 pikë përqindje në muajin nëntor. Ky zhvillim u përcaktua nga vlerësime më optimiste për *porositë aktuale në ndërtim*, si dhe për punësimin në të ardhmen. Vlerësimi për *aktivitetin aktual* në sektorin e ndërtimit regjistroi gjithashtu rritje, por në një masë më të vogël se komponentët e tjetër të TBN-së. Rritje të lehtë kanë pësuar dhe *pritjet për çmimet* në të ardhmen (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve\*




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.  
Shënim: \*Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

**Treguesi i besimit në shërbime (TBSH)** shënoi një kthesë pozitive, duke u rritur me 3.2 pikë përqindje në muajin nëntor, pasi kishte shënuar rënie gjatë katër muajve paraardhës. Rritja e TBSH-së u ndikuar nga vlerësime pozitive, si për *ecurinë aktuale të biznesit* ashtu edhe për nivelin e *kërkesës*. Vlerësimet e bizneseve të shërbimeve për nivelin e *punësimit* nuk kanë ndryshime të ndjeshme nga muaji i kaluar. Pritjet e tyre për *ecurinë* e çmimeve në të ardhmen regjistruan rënie (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

**Treguesi i besimit në tregti (TBT)** shënoi rritje të lehtë me 0.5 pikë përqindje. Bizneset e tregtisë vlerësuan më pozitivisht *ecurinë aktuale të biznesit të tyre*, si dhe presin rritje të lehtë të *punësimit* (Tabelë 2, sektori i tregtisë). Pritjet për çmimet që do të vendosin në të ardhmen janë vlerësuar në rënie.


**Treguesi i besimit konsumator (TBK)** rezultoi me rritje të lehtë në muajin nëntor, duke reflektuar përmirësime të vogla në të katër komponentët përbërës: pritjet për situatën *ekonomike e financiare* si dhe vlerësimi për *blerjet në shuma të mëdha*, si në periudhën aktuale ashtu edhe në të ardhmen (Grafik 2). Pritjet për *papunësinë* dhe nivelin e përgjithshëm të çmimeve në të ardhmen janë rishikuar për poshtë këtë muaj.

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shumë të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve\*

	Vlerat			2022						Situata aktuale	
	min	mes	max	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Koniunkturale**	Strukturore***
Industri	-59.4	-12.3	6.1	6.0	2.4	-2.4	-2.1	-7.3	-11.1	↓	+
Ndërtim	-57.1	-28.2	-4.9	-8.0	-10.3	-4.9	-10.7	-17.6	-11.8	↑	++
Shërbime	-45.2	5	26.5	26.5	19.7	13.5	10.7	10.0	13.2	↑	+
Tregti	-32.0	-2.5	18	8.1	6.6	1.9	2.9	0.4	0.9	↑	+
Konsumator	-39.8	-25.3	-16.3	-34.8	-34.9	-32.7	-35.8	-35.1	-34.2	↑	--

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

\*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

\*\*\*) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

\*\*\*\*) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2022								
	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nëntor
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	19.2	20.0	28.7	28.8	21.3	18.7	17.1	11.6	7.9
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-13.8	-17.6	-13.6	-3.1	-7.9	-9.4	-7.6	-14.5	-17.9
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-19.0	-17.7	-17.0	-7.8	-6.2	-16.3	-15.7	-18.9	-23.4
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-5.7	-7.4	-5.9	-6.2	-6.4	-6.9	-0.5	-1.1	-3.3
Prodhimi pritje (pyetja 5)	24.1	27.9	30.2	24.7	29.9	34.3	31.0	32.1	33.6
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	70.2	66.6	50.2	50.9	50.9	30.8	47.7	36.0	31.1
Punësimi pritje (pyetja 7)	8.7	14.5	17.8	14.6	13.4	9.6	9.3	10.7	6.9
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	1.1	1.9	2.8	11.7	8.4	24.9	6.8	3.4	4.8
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-39.2	-33.3	-31.0	-27.8	-29.0	-34.7	-28.1	-38.6	-28.4
Punësimi pritje (pyetja 4)	3.0	-0.2	5.2	7.4	4.7	21.5	12.1	8.0	16.7
Çmimet pritje (pyetja 5)	49.3	44.9	32.9	47.7	40.8	39.6	38.9	43.8	45.7
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	21.4	21.5	25.0	25.4	22.3	13.8	11.3	8.5	13.0
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	22.8	17.9	27.4	27.7	17.1	13.2	10.1	11.5	13.4
Kërkesa pritje (pyetja 3)	25.4	27.5	37.1	37.1	36.1	26.2	31.5	20.0	25.1
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	6.6	13.8	9.9	20.4	5.3	6.5	3.6	5.2	3.8
Punësimi pritje (pyetja 5)	12.6	11.1	12.2	6.2	7.9	8.9	15.4	4.6	8.0
Çmimet pritje (pyetja 6)	48.4	38.6	45.5	35.9	34.9	23.9	27.3	30.3	20.6
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	6.6	6.2	14.4	13.4	11.7	3.2	5.1	-1.1	-0.5
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	-0.8	2.9	4.9	1.2	0.4	5.1	0.7	0.9	3.0
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	14.3	5.7	13.0	17.6	22.2	12.5	10.4	14.3	16.5
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	14.7	12.8	14.6	23.4	22.0	15.4	17.3	14.9	21.6
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	3.1	-1.6	3.8	2.9	1.6	0.5	0.7	1.8	2.2
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	59.4	50.3	45.7	39.6	44.0	37.1	41.3	30.8	28.3
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-15.4	-17.3	-17.8	-18.5	-19.9	-15.9	-19.0	-21.2	-20.0
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	-11.8	-7.5	-6.3	-5.1	-7.1	-4.4	-4.4	-5.6	-4.0
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-26.3	-31.1	-31.2	-29.5	-32.2	-30.2	-32.2	-32.5	-32.2
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	-17.9	-16.1	-10.4	-12.5	-12.4	-6.4	-15.7	-13.8	-12.8
Çmimet aktuale (pyetja 5)	38.7	53.0	50.7	51.9	54.0	51.6	49.4	53.7	49.0
Çmimet pritje (pyetja 6)	17.5	5.6	3.7	6.1	2.9	0.3	3.5	3.2	-3.2
Papunësia pritje (pyetja 7)	13.1	11.8	10.5	10.0	10.1	9.3	12.4	14.7	8.2
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-71.1	-69.3	-68.9	-69.1	-66.6	-66.1	-68.1	-66.5	-66.2
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-49.9	-50.8	-50.6	-52.4	-53.5	-54.1	-55.0	-54.6	-53.7
Kursimi aktual (pyetja 10)	-48.1	-47.8	-47.2	-47.9	-49.3	-48.1	-49.6	-48.2	-48.2
Kursimi pritje (pyetja 11)	-50.4	-47.8	-45.8	-46.2	-45.7	-44.1	-44.7	-44.7	-42.5
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	-0.8	0.0	0.1	0.2	1.7	2.4	1.1	1.1	2.1

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

# ANEKS

## Shpjegime metodologjike

**Balanca** është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

**Treguesi i Besimit (TB)** ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve, të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

**Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE)** ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.